

SHQIPERIA ME LENDET E SAJ TE PARA KRITIKE (CRM) DHE STRATEGJIKE (SRM), SI POTENCIAL MINERAR QE DUHET KONSIDERUAR NGA BE



Prof. Dr. Sokol Mati*

* *Këshilltar i Bordit të Drejtorëve* - Beralb ShA,

* *Pedagog*, Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave.

SHQIPERIA DHE POLITIKAT EUROPIANE PER MINERALET KRITIKE (CRM DHE SRM)

Situata aktuale dhe zhvillimi përspektiv në aktivitetin mineral, tregu dhe kërkesat për minerale, sidomos të atyre kritike apo strategjike kërkojnë domosdoshmërisht një aplikim rigoroz të legjislacionit të miratuar dhe një strategji afatgjatë të përshtatur me reformat politike e institucionale që realizohen në vend në kuadër të prioriteteve strategjike, si turizmi, energjitika, integrimi evropian për ta parë industrinë minerare jo thjesht si dëmtuese të mjedisit, por si mbështetje për zhvillim dhe ndihmesë e madhe në zgjidhjen e shumë problematikave, që lidhen me punësimin e aspekte të tjera sociale të rajoneve minerare duke garantuar një mjedis mineral të pastër e të qëndrueshëm. Përmirësimet në strukturat institucionale të shërbimit mineral dhe bazën legale e rregullatore të këtij aktiviteti duhet të krijojnë mundësi për shfrytëzim racional të potencialit të minerar nepermjet aplikimit korrekt të ligjit, dhe një vizion të qartë për misionin që ka kjo industri në ekonominë shqiptare me moton "Minerale dhe Energji për një zhvillim të qëndrueshëm".

Bashkimi Evropian në vlerësimin e lendeve të para jo-energjitike, si lende të para kritike apo lende të para strategjike në Raportin final të vitit 2023, (*Study on the Critical Raw Materials for the EU-2023-Final Report*), i përgatitur në kuadër të punës për një nga tre shtyllat e strategjise së lendeve të para kritike të nisur në nëntor 2008, (*COM [2008] 699 "The raw materials initiative — meeting our critical needs for growth and jobs in Europe"*), ka shtuar dhe metalet baker e nikel.

Lista me 34 mineralet të propozuara si lista e lendeve të para kritike (CRM) për vitin 2023 për Bashkimin Evropian.

2023 Lendet e para kritike (shitesat në kete liste me font italic)			
aluminium/bauxite	coking coal	lithium	phosphorus
antimony	<i>feldspar</i>	LREE	scandium
<i>arsenic</i>	fluorspar	magnesium	silicon metal
baryte	gallium	<i>manganese</i>	strontium
beryllium	germanium	natural graphite	tantalum
bismuth	hafnium	niobium	titanium metal
boron/borate	<i>helium</i>	PGM	tungsten
cobalt	HREE	phosphate rock	vanadium
		<i>copper*(bakri)</i>	<i>nickel*(nikeli)</i>

Lista me 34 mineralet të propozuara si lista e lendeve të para strategjike (SRM) për vitin 2023 për Bashkimin Evropian.

2023 Lendet e para strategjike (shitesat në kete liste me font italic)			
aluminium/bauxite	coking coal	<i>lithium</i>	phosphorus
antimony	feldspar	<i>LREE</i>	scandium
arsenic	fluorspar	<i>magnesium</i>	<i>silicon metal</i>
baryte	<i>gallium</i>	<i>manganese</i>	strontium
beryllium	<i>germanium</i>	<i>natural graphite</i>	tantalum
<i>bismuth</i>	hafnium	niobium	<i>titanium metal</i>
<i>boron/borate</i>	helium	<i>PGM</i>	<i>tungsten</i>
<i>cobalt</i>	<i>HREE</i>	phosphate rock	vanadium
		<i>copper*(bakri)</i>	<i>nickel*(nikeli)</i>

BE për të diversifikuar burimet e furnizimit, garantuar sigurimin e lëndëve të para jo-energjetike për zinxhirët e vlerës industriale të BE-së po ecen me një strategji aktive duke vlerësuar krahas riciklimit, të marrë lëndë të para primare nga BE-ja dhe vendet e treta që aspirojnë të jene në BE, duke rritur furnizimin e lëndëve të para dytësore përmes efikasitetit dhe qarkullimit të burimeve dhe gjetjen e alternativave ndaj lëndëve të para kritike.

Strategjia e BE për CRM dhe SRM i vlerëson lëndët e para thelbësore për transformimin e gjelbër dhe dixhital të Evropës dhe kërkon të transformojë ato në një forcë strategjike për Evropën duke zvogëluar varësinë e furnizimit,

diversifikuar ofertën dhe burimet e furnizimit, me rritjen e minierave brenda BE, investimit në inovacionin në miniera (*miniera plotësisht të dixhitalizuara dhe të automatizuara, të cilat do të përmirësojnë efikasitetin, sigurinë, do të minimizojnë ndikimin mjedisor dhe do të rrisin pranimin shoqëror të minierave*), në arsimim (*zhvillimi i talentëve dhe rritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore evropiane të lëndëve të para, të kualifikuar në miniera të qëndrueshme, shkencën e materialeve dhe teknologjitë e riciklimit*), në zgjerimin e kapacitetit përpunues të mineraleve e materialeve dhe riciklimin që të nxisë rritjen ekonomike dhe reduktojë ndjeshëm ndikimet mjedisore, duke ndërtuar themelet për një Evropë të qëndrueshme, konkurruese dhe të pavarur. Situata aktuale dhe zhvillimi perspektiv në aktivitetin mineralar global, tregu dhe kërkesat për minerale, sidomos të atyre kritike apo strategjike në BE, vendndodhja gjeografike e vendburimeve minerale, do të ushtrojnë presion mbi furnizimin e Evropës me minerale sidomos për lëndet e para metalike.

Pare në këtë kuader duhet, që strategjia dhe politikat tona minerare të jenë në linjë me këto prioritete, si në aspektet e riciklimit, inovacionit, rritjes së kapaciteteve profesionale por infrastrukturore të institucioneve minerare.

Duke vlerësuar potencialin tone mineralar dhe mundësitë nga ky ndryshim i strategjise së BE, veprimtaritë minerare duhet të drejtohen në rritjen e prodhimit të mineraleve (veçanrisht për CRM dhe SRM), nëpërmjet një shfrytëzimi racional, ekologjik duke rritur përpunimin e tyre në vend për produkte të gatshme për industrinë e ndryshme të makinave, aeronautikës, kimike, etj.

Në këtë kuader potenciali ynë mineralar mund të jetë ndihmes në këtë periudhë negociimi me BE (*negocimi i disa kapitujve si kapitujt 8: Politika e Konkurrencës; 20: Ndërmarrjet dhe Politika Industriale; 25: Shkenca dhe Kërkimi; 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimaterike*), pasi siguria e furnizimit me lëndë të para minerale kritike është një parakusht për një rritje të qëndrueshme.

Shqipëria me resurset e saj minerale ka shumë mundësi për të bërë të rëndësishëm kontributin e saj për lëndet e para të tashme, që në listat e CRM dhe SRM janë shtuar dhe metale të bakrit e nikelit dhe të jete konkurruese me produkte minerare të tregjës evropiane. Kjo do të jepte vlerë të shtuar burimeve tona minerale dhe do të shkonte në drejtim të një shfrytëzimi racional të tyre, inkurajimit të rritjes së prodhimit dhe përpunimit të xehoreve metalore, përmirësimit të klimës për investime të huaja, lehtësimit të barrierave administrative, promovimit dhe mbështetjes të bizneseve me vlerë të shtuar jo pengimin e tyre, duke ruajtur profesionalizmin dhe rritur transparencën për një impakt të shtuar në ekonomi.

Ky orientim i ri në politikat e BE karshi qasjes për lëndet e para kritike na jep mundësi në vendeve të Ballkanit me një potencial të vlerësuar me vendburime të vogla deri të nivelit të mesëm sidomos për bakrin e nikelin, që të orientojmë politikat tona minerare për të qenë koherente me politikat evropiane për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit mineralar, me qëllim të garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm e të harmonizuar dhe fitim maksimal të shtetasve shqiptarë.

Në aspektin e lëndëve të para kritike puna jone gjykoj që duhet të orientohet në disa drejtime që lidhen me:

- ⇒ mineralet të cilat përfshihen në këtë listë për të cilat Shqipëria ka një informacion gjeologjik të reduktuar ose thënë me mire jo të plotë dhe të pavlerësuar si nga ana gjeologjike por dhe e rezervave, (*si Litiumi, LREE, PGM, etj*), ndaj kerkohet ofrim i veprimtarive të kerkim-zbulimit sipas principit “I pari në kohë I pari në të drejta”, pjesë e legjislacionit mineralar pak ose aspak i aplikuar për të eliminuar procedurat burokratike të lejdhjes apo konkurimit mbi objekte kerkimi pothuaj pa informacion gjeologjik.
- ⇒ disa minerale të tjere pjesë të kësaj liste, (*si titano-magnetitet, boksidet, vanad, feldshpati, fluorite, mangani, fosforite, etj*) për të cilat ka informacion gjeologjik dhe vlerësim të rezervave qoftë dhe sipas standarteve A, B, C1 dhe C2, të realizohet një rivlerësim i rezervave bazuar në sistemet e klasifikimit ndërkombëtar të rezervave, që të mund të promovohen, të ketë mundësi të tërhiqen investime si në drejtim të nxjerrjes së tyre por me teper në drejtim të përpunimit të tyre me metoda të reja inovative.
- ⇒ mineralet si bakri e nikeli ku mund të thuhet se informacioni gjeologjik apo dhe ai i vlerësimit të rezervave ka qenë shumë me i madh dhe i plotë, puna duhet të orientohet në përdorimin e metodave inovative në proceset e përpunimit, riciklimin e mbetjeve minerare, pa lene menjane rivlerësim sipas standarteve ndërkombëtare të rezervave për të krijuar hapësira dhe iniciuar dialogun e partneriteteve strategjike të BE-së.
- ⇒ një bashkëpunim me BE për përfshirje në studime gjeologjike kombëtare dhe rajonale, pjesëmarrje aktive në institucionet evropiane të sektorit mineralar për të përmirësuar bazën e njohurive të depozitave minerale, lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe shpërndarjen e të dhënave për rajonin tone dhe me gjere me gjithë BE, ndërtimin

e rritjen e kapaciteteve intelektuale por dhe të infrastruktures studimore, përmirësimin e ndërveprimit, shkëmbimin e praktikave më të mira.


MINERALET E BAKRIT DHE NIKELIT NE BALLKAN DHE SHQIPERI

Te dy keta minerale kane rezerva qe konsiderohet deri te nivelit te mesem ne rajonin e ballkanit.

Rezervat e nikelit per gjithë Ballkanin vleresohen me 9,596 milion ton metal nikel rezerva gjeologjike dhe perbejne 1.63% te rezervave boterore te ketij metali.

Përmbledhëse e rezervave të xeheroreve të Fe-Ni dhe Ni-Si, sipas rajoneve ne Ballkan

Shtetet	Vendosja e objekteve minerare	Sasia e rezervave gjeologjike te xeheroreve te nikelit (ne milion ton)	Permbajtja e Nikelit (% Ni)	Sasia e Nikelit metal (ne milion ton metal)
Shqiperia	Objektet ne Jug lindje (Bitincke, Kokogllave, Strana, Kapshtica, etj); zonen Qendrore (Librazhd-Pogradec); zonen verilindore (Has-Kukes-Lure)	311,70	1,06%	3,30
Greqia	Objektet ne Kastoria, Agios Ioannis, Evia	280,60	1,16%	3,25
Maqedonia e Veriut	Objektet ne Ržanovo, Takovo, Rakle	230,00	0,48%	1,10
Serbia	Objektet ne Mokra Gora , Serbine perendimore, rajoni Šumadija	150,00	0,85%	1,28
Bosnia Herzegovina	Objekti ne Vardište	67,00	0,80%	0,54
Kosova	Objektet ne Çikatova, Glavica	10,00	1,22%	0,12
Total Vendet e Ballkanit		1 049,30	0,91%	9,596
Turqia	Objektet ne Çaldag , Gördes	99,70	1,03%	1,03
Total (Ballkani dhe Turqia)		1 149,00	0,92%	10,62




Rezervat e bakrit per gjithë Ballkanin vleresohen me 6,467 milion ton metal baker rezerva dhe perbejne 0,31% te rezervave boterore te ketij metali.

Përmbledhëse e rezervave të xeheroreve të bakrit, sipas rajoneve ne Ballkan

Shtetet	Vendosja e objekteve minerare	Sasia e rezervave gjeologjike te xeheroreve te bakrit (ne milion ton)	Permbajtja mesatare e bakrit (% Cu)	Sasia e bakrit metal (ne milion ton metal)
Shqiperia	<u>Rajoni Kukesit</u> : Golaj, Nikoliq 1 dhe 2, Krume, Gjegan, Leproi-Shenmeri, Gdhesht, Gjegan, Thire; <u>Rajoni Pukes</u> : Munella, Qaf bari, Tuci, Tuci lindor, Paluce, Lak Roshi, Qaf Bari Kcire, Paluce, Rr. Rinise, Fushe Arresi; <u>Rajoni Mirdites</u> : Spac, Repts, Gurth, Maja e madhe, Letitne, Gurth Spac, Perlat, Laj, Kullaxhi, Kurbnesh, Derven, Kacinar, Rrenjolle, Thirra, Rubik, Shmi, Kabash, Kcire.; <u>Rajoni Palaj-Karme</u> : Palaj, Karma 1, Karma 2; <u>Rajoni Korces</u> : Rehove-Bregu i Geshtenjes- Vithkuq, Ciflik, Dushk, Porave.	40	1,61%	0,640
Greqia	Objektet ne Olympias dhe Skouries.	6	0,53%	0,030
Maqedonia e Veriut	Objektet ne Buchim te Radovis	11	1,20%	0,134
Serbia	Objektet ne Bor, Jama Mine (Borska Reka, Cerovo, Dumitru Potok, Kiseljak), Majdanpek mine (West dhe Pojas), Veliki Krivelj mine, Levonac, Timok, Tulare, Donje Nevlje dhe Donje Tlamino	476	1,19%	5,664
Total Vendet e Ballkanit		532	1,21%	6,467
Turqia	Objektet ne Kastamonu, Murgul, Anayatak, Cakmakkaya, Artvin, Tepeoba, Kocayayla, Yenice, Canakkale, Sebinkarahisar, Yomra, Cayeli, Madenkoy, Lahanos, etj.	631	1,03%	6,500
Total (Ballkani dhe Turqia)		1 164	1,11%	19,435

SASIA E BAKRIT METAL (NE MILION TON BAKER METAL)





Per keta dy metale krahas disa vendeve të Ballkanit, Shqipëria vlerësohet me rezerva per vendburime të vegjel deri ne të mesem, me permbajtje të Cu dhe Ni ne keto rezerva ne nivelet deri ne mesatare.

Burimet totale gjeologjike (A+B+C1+C2) të vendburimeve të xeheroreve te nikelit ne Shqipëri vlerësohen të jenë rreth 310 milion ton xehesor Fe-Ni dhe Ni-Si me një përmbajtje mesatare prej 1,06 % Ni , dhe 0,044 % Co (230,3 milionë ton xehesor Fe-Ni me permbajtje 1,027 % Ni dhe 0,038 % Co dhe xehesor nikel-silikati 81,4 milionë ton me permbajtje 1,145 % Ni, dhe 0,061% Co; pra rreth 3,22 milion ton nikel metal ose rreth 0,49% e rezervave te identifikuar ne bote te ketij minerali).

Përmbledhëse e rezervave të xeheroreve te Fe-Ni dhe Ni-Si, sipas rajoneve ne Shqipëri

Rezervat e vleresuara gjeologjike (A+B+C1+C2) te hekur-nikelit dhe nikelit silikat ne Shqipëri					
Xeheriori	Sasi (000/ton)	Fe%	Ni %	SiO ₂ %	Co %
1. Devolli					
Total Ni-Si	52 179	16,600	1,200	35,120	0,060
Total Fe-Ni	59 193	38,660	1,074	12,200	0,056
Total Fe-Ni + Ni-Si	111 372	28,325	1,133	22,938	0,058
2. Kukësi					
Total Ni-Si	29 221	21,730	1,047	40,120	0,063
Total Fe-Ni	65 504	37,220	1,029	26,930	0,055
Total Fe-Ni + Ni-Si	94 725	32,442	1,035	30,999	0,057
3. Librazhd-Pogradec					
Total Fe-Ni	105 592	44,720	1,000	9,780	0,017
Total Shqipëria					
Total Fe-Ni	230 289	41,029	1,027	15,280	0,038
Total Ni-Si	81 400	18,442	1,145	36,915	0,061
Total Fe-Ni + Ni-Si	311 689	35,130	1,058	20,930	0,044

Depozitimet e mineraleve të nikelit jane të shperndara ne tre rajone kryesore Kukësi, Librazhd-Pogradeci dhe Devolli. Per kete mineral duhet te kemi një vizion i qartë me objektiva e një plan veprimi real, ide të reja mbi metodat e trajtimit të xeheroreve tane te nikel-silikatit dhe hekur-nikelit dhe mbi të gjitha t'i zbatojmë ato drejt dhe në kohë.




Krijimi i mundësive për trajtimin ne Shqipëri si një proces me vlerë të shtuar, aktualisht eshte bere domosdoshmeri per industrinë minerare të nikelit si një burim i munguar fitimi për ekonomine e vendit, si burim i madh punësimi dhe si sektor mbeshtetes për zhvillimin e qëndrueshëm sidomos të sektorit minerar dhe ekonomisë ne teresi. Nisur nga vlerësimet e gjendjes aktuale të industrise së nikelit në vendin tonë për perspektivën e zhvillimit të saj jane :

- Projekti per rajonin juglindor me nje objekt perpunues (Bitincka, Kokogllave, Tren, Strana, Kapshtica).
- Projekti per rajonin verior e verilindor me nje objekt perpunues (Trull, Surroi, Mamez, Nome duke perfshire këtu dhe rajonin e Lures).
- Projekti per rajonin e Librazhd-Prenjas-Pogradecit per hekur nikel me nje objekt përpunues. Ose nje objekt i vetem perpunues ne qender me kapacitet perpunimi per te tre zonat kryesore.

Burimet totale gjeologjike (A+B+C1+C2) të vendburimeve të *xehereve te bakrit ne Shqiperi* llogaritentë jone 39,7 milion Ton me nje permbajtje mesatare 1,6 % Cu. Vendburimet e bakrit ndodhen ne ofiolitet e Albanideve, kryesisht ne pjesen e sipërme dhe te mesme te kesaj sekuence. Nga aspekti gjeografik zona me e rendesishme e vendodhjes se ketij xeherori eshte Mirdita Qendore, ku jane shume te perhapur shkembijte vullkanike. Nga vendosja gjeografike vendburimet e bakrit ndodhen kryesisht ne zonat Has-Kukes (Golaj, Nikoliq-1.2, Gjegjan, Shenmeri dhe Gdhesht, etj), Puke (Munella, Tuc, QafBari, Rruge e Rinise, Kcire, Paluc-Lak Roshi, Fush Aresi etj), Mirdite (Spac, Gurth 1, 2, 3, Laj - Kullashi, Kurbnesh, Perlat, Drenove, Derven, Rubik, etj) dhe me pak ne Shkoder (Palaj, Karma 1, 2, Turec-Vig, etj) e Korce (Rehove, Bregu i Geshtenjes, etj). Rezervat gjeologjike aktuale te ketij xeherori.

Përmbledhëse e rezervave të xehereve te bakrit, sipas vendburimeve kryesore ne Shqiperi

Objekte minerare	Rezervat minerare gjeologjike (ne ton)	Permbajtja e Cu (ne %)	Objekte minerare	Rezervat minerare gjeologjike (ne ton)	Permbajtja e Cu (ne %)
Golaj	429630	0.62	Rruga e rinise	680920	1.00
Nikoliq-1	518000	1.68	Qaf bari	338774	1.23
Nikoliq-2	663344	2.23	Munelle	8272566	1.00
Krume	125683	2.98	Gurth spac	1716694	1.35
Leproji(shemri)	405362	1.36	Spac	5446749	1.04
Gdheshte	274000	1.00	Maja e madhe	53713	0.60
Gjegjan	61256	2.56	Laj	252646	0.97
Thire	737000	0.94	Kullaxhi	370094	0.89
Kurbnesh	133470	1.30	Perlat	2525889	2.51
Shmi	900	1.40	Karriere perlat	18000	2.08
Kabash	42000	2.60	Rrenjolle	12000	1.07
Kcire	203539	1.45	Kacinar	126334	1.45
Fushe arresi	1115612	1.04	Derven	3147620	0.77
Porave	115000	1.50	Palaj-karme	1170000	2.24
Paluce	323626	1.25	rubik	968570	1.86
Lak roshi	3878100	1.65	Rehove	3242500	2.10
Tuc	2100000	1.00	Porave	185158	1.85
Tuci lindor	1116926	2.03	Total	39 722 005	1.60



Minerali i Bakrit i cili ka potencial eksplorues shume te larte për vendburime te vogla deri ne te mesme kerkon terheqjen e kompanive minerare, te cilat janë ne gjendje te përdorin teknologji moderne eksploruese dhe studime komplekse qe do te sherbejne si baze e nevojshme te dhenash per te terhequr kompanite ne procese investuese shfrytezimi. Bazuar ne situaten ekzistuese te industrise se bakrit, riaktivizimi i saj sot sipas skemes ekzistuese do te ishte nje ndermarrje e vershtire dhe pa rezultat, nje proces i tille mund te kryhet kur do te kete nje sasi rezervash te vleresuara qe do te justifikojne ngritjen e nje metalurgjie te re, apo metoda te reja inovative te hidrometalurgjise per perpunimin e xehereve te bakrit. Projekte te se ardhmes per prodhim koncentratesh bakri jane:

- Projekti per 2 million ton rezerva ne zonën e Perlatit Jugor per prodhim koncentratit bakri.
- Projekti per 3.5 million ton rezerva ne zonën e Mirdite Puke duke perfshire disa zona minerare me nje objekt përpunues Jugor per prodhim koncentratit bakri.
- Projekte kërkim zbulimi ne rajonin e Mirdites, Pukes.

➤ Riciklimi i mbetjeve minerare te objekteve përpunuese te bakrit.

VLERA E POTENCIALIT GJEOLLOJIK DHE GJENDJA AKTUALE E PRODHIMIT MINERAR NE SHQIPERI

Nga studimet dhe punimet gjeologjike të kerkim-zbulimit të kryera, pergjate 80 viteve janë konkretizuar vendburime të rëndësishme të mineraleve në Shqiperi. Rezervat gjeologjike të dhena gjithsesi kerkojne rikonfirmimin e tyre, bazuar ne konceptet e reja të klasifikimit të rezervave minerare, por mbi bazen e tyre mund të vleresohen disa projekte të rendesishme minerare. E rendesishme eshtë që në planifikimin minerar projektet e reja minerare të kalojne ne projekte per nje nivel të caktuar rezervash qe të bejne të mundur investimin ne perpunimin e metejshem të mineralit deri ne produkte perfundimtare minerare. Premisat gjeologjike per minerale kryesore metalike si per krom, baker, hekur-nikel, nikel-silikat, titanomagnetit, etj, jane vleresuar te jene disa qindra milione ton.

Ne nje perlloraritje te realizuar per vleren e produkteve perfundimtare minerare qe mund të realizohen nga rezervat e vleresuara duke u bazuar ne koeficientet e shfrytezimit (*humbje, varferim*), perpunimit (*rikuperimit ne pasurim e metalurgji, e rafinim*) per produkte finale ne tregjet minerare sipas cmimeve të ketyre produkteve minerare ne vitin 2025, Shqiperia ka potencial minerar të perlloratur me nje vlere rreth 158 miliard USD dhe mund të garantoje nje të ardhur shtetit nese keto minerale shfrytëzohen ne 50 vite vetëm nga renta minerare ne mbi 2 miliarde USD (*perlloraritja e perafruar me stadin e tanishem të takses se rentës minerare*), ne nje kohe kur per produktet tona minerare me nivelin e shfrytezimit aktual, vlera e rentës minerare vjetore ne asnje vit nuk e ka kaluar 3milion USD/vit.


Ketë pasuri të fjetur ne duhet ta riveme ne pune, dhe venja e saj ne pune duhet bere ne menyre racionale, miqesore me mjedisin dhe e pranuar nga komunitetet qe banojne ne zonat minerare, duke menduar jo thjesht per brezin tone por dhe per brezat e ardhshem. Potencialin tone minerar duhet ta perdorim per të qene konkurent ne rajon (BE) dhe si nje mjet ndihmes ne procesin e negocimit per kapitujt e ekonomise dhe politikave industriale, sot kur dhe strategjia e BE per CRM dhe SRM po merr vemendje me të madhe. Sot Shqiperia me potencialin e saj minerar mund të luaj nje rol të rendesishem ne sigurine rajonale të furnizimit me lende të para kritike, për t'u bërë një kontribues i rëndësishëm në zinxhirin kritik të furnizimit të lëndëve të para në Evropë element qe do të na sherbeje per të qene konkurent ne rajon e BE por dhe globalisht me produkte minerare.

Vlera ne USD e rezerves minerale të vleresuar ne produkt të shitshem me cmimet ne tregun global per vitin 2025

Nr.	Minerali	Permbajtja e elementë ve të dobishem	Vlera ne USD e rezerves minerale të vleresuar të konvertuar ne produkt të shitshem me cmimet ne tregun global per vitin 2025
1	Kromi	8-46 % Cr2O3	6 808 314 024
2	Bakri	1.3% - 2.5% Cu	3 444 895 483
3	Zinku	1.92 % Zn	255 888 109
4	Plumbi	0.28 % Pb	41 743 944
5	Alumini	Al2O3- 32-55%; SiO2 – 3-13.42 %, Fe2O3 13.7-26.11 %; TiO2 1.7-2.6 %, CaO 2-2.4%, MgO 0.3-0.5%,Moduli Al2O3/SiO2 3-10.2	5 169 776 132
6	Ari	Au 1-4.4 gr/t (total I perlloratur 13742 kg Au)	563 564 917
7	Argjendi	Ag I llogaritur si bashkeshoqerues ne mineralet e bakrit	96 383 229
8	Platini	Pt 1.43-1.65gr/t, Pd 0.12-4.34 gr/ton, Os 0.04-0.17 gr/ton, Ru 0.03-0.35 gr/ton, Ir 0.02-0.3 gr/ton, Rh 0.015-0.2 gr/ton, (Totali I perlloratur 848 kg Pt)	645 132
9	Mangani	15-35 % MnO	8 653 524
10	Titano-Magnetite	TiO2 5.56– 6.47 %; Fe2O3 17.04– 18.56%; V2O5 – 0.19-0.21%	20 081 393 314
11	Titani dhe Vanadi	32-240 kg/ton TiO2, 1.1-2.05 kg/ton V2O5	4 930 860 000
12	Polimetalet	Cu 0.15-0.89, Zn 0.15-0.89%, Pb 0.15-0.29%, Au 0.39gr/t, Ag 6.5 gr/t, S 12%	148 500 000
13	Uranium	0.77 % U3O8,Intensiteti 50-500 (µR/h)	1 492 862
14	Hekur-nikel	Fe- 20- 44%; Ni-0.2-1.08%; SiO2-12.8-28.12%; Co 0.048-0.063%	30 437 173 231
15	Nikel siliikat	Fe -18.3%; Ni-1.13%; SiO2- 36.92%; Co- 0.043%	15 243 845 760
16	Magnezite	MgO 35-45%, SiO2 0.5-13%, CaO 0.3–3.6%, Fe2O3 0.4-3.8 %, Al2O3 0.5-0.75 %	467 114 667
17	Arseniku	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
18	Zhiva	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
19	Vanadium	0.18-0.3 % V2O5	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
20	Dausoniti	Al2O3 30-37 %, Na2O 15-21 %, H2O+ 4 %, H2O 0.5-1 % dhe CO2 36-37 %.	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
21	Ceolitë t	SiO2 51.50 %, Na2O 0.03 %, Al2O3 24.3 %, K2O 0.1 %, H2O+ 12.5 %, H2O 1.7 %.	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
22	Qymyret	3600 kkal/kg	2 631 327 251
23	Grafiti	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
24	Torfat	Fuqia kalorifike 1790-2907 kkal/kg, lageshtia 11.3%, hiri 30%, S total 1.1-1.16 %	3 300 000 000
25	Bitumi	4.41-9.73% rralle 11.94% bitum, lëndët flurore 69.7-77.2 %, fuqia kalorifike8561-9673 k.kal/kg, S 5.3-7.35 %, C 74.48-80.89 %, H2 4.5-8.9 %, O2 3.15-3.7%, N 1 %. temperatura e flakërimit 280-310o, pika e zbutjes 120o, hiri 17-18 %, asfaltene 42 %, naftene 29 %.	266 868 000
26	Pirrobitumet (zhavorret bituminoze)	2000-3000kkal/kg, C 78-80.6%,O2 3.4-11 %, H2 4.85-9.24 %, N 0.7-1.4 %, S 2.5-7.81 %, lagështia 2-6 %.	2 151 093 750
27	Qymyri bituminoz	3500-7400kkal/kg, C 82-90.6%	50 832 000
28	Rerat bituminoze	8-10% bitum	5 210 280 000
29	Gelqerore	CaO-50-55%, MgO-0.25-4%, SiO2 15-23%, Fe2O3-0.1-0.8%	593 222 652
30	Dolomitet	CaO-30.34%; MgO- 18.21%, Fe2O3- 0.14-0.43%	192 000 000
31	Merzelet	CaO-36-38%, MgO-73-77%, SiO2 –1.9-2.6%, Fe2O3- 2.1-3.5%	3 081 600
32	Trepelet	CaO-0.03-0.35%, MgO-18-28%, SiO2 –1.5-4.9%, Fe2O3- 0.41-1.5%	7 680 000
33	Guret dekorative karbonatike	CaO 53.36%, MgO 0.8 %, SiO2 0.05 %, Fe2O3 0.48%	1 613 983 147
34	Olivinite	MgO 48.24 %, SiO2 38.36 %, Al2O3 0.25 %, Fe2O3 7.65 %, CaO 0.25 %, Cr2O3 0.39 %	1 953 000 000
35	Dunitet	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
36	Harcburgitet	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja

37	Piroksenitet	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
38	Gabrot, troktolet dhe gabrot olivinike	Të pa-analizuara	140 000 000
39	Dioritet, plagiogranitet dhe granitet,	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
40	Serpentinitet	Të pa-analizuara	Të pavleresuara nga ana sasiore, Të pa-analizuara nga permbajtja
41	Gipsi	CaO -34%, SO ₃ -49%, H ₂ O -5.8%, CaSO ₄ 2H ₂ O -90%	1 535 517 620
42	Travertinat	CaO 33-53%, MgO 0.6-3%, SiO ₂ 0.7-9%, Fe ₂ O ₃ 0.4-1.5%	1 952 205 696
43	Mermeret	CaO- 11-32%, MgO-0.3-18.3%, SiO ₂ 25-33%, Fe ₂ O ₃ - 0.1-0.8%	3 780 000 000
44	Bazaltet	SiO ₂ 50.56 %, Fe ₂ O ₃ 13.17 %, Al ₂ O ₃ 12.90 %, CaO 10.09 %, MgO 5.85 %, Na ₂ O 2.87 %, TiO ₂ 1.16 % dhe HK 2.34 %	9 000 000 000
45	Argjilat	Al ₂ O ₃ - 11-14%, MgO- 2.6-7%, SiO ₂ - 43-51%, Fe ₂ O ₃ - 0.4-11%, CaO -0.7- 0.8%, TiO ₂ - 0.3-0.7%	1 575 942 000
46	Kaolinat	Al ₂ O ₃ - 29-35%, MgO- 2.8- 8%, SiO ₂ - 43-46.8%, FeO - 3.38 %, CaO -1.4-1.9%,	38 000 000
47	Tufet vullkanike	Al ₂ O ₃ -13.21-66.7%,MgO-1.1-3.14%, SiO ₂ -1.09-62.09%, Fe ₂ O ₃ -3.01-17.37%, CaO 2.17-3.69%, Na ₂ O+K ₂ O- 0.36%	75 000 000
48	Xhami vullkanik	Al ₂ O ₃ - 9.8-10.7%, MgO- 0.4-0.9%, SiO ₂ - 63.4%, Fe ₂ O ₃ - 1.1 - 5%, CaO -4.6-4.8%, TiO ₂ - 0.27-0.64%, Na ₂ O -1.4-2%, K ₂ o - 0.27%	326 375 000
49	Bojrat e dheut	MgO - .88-9.29%, SiO ₂ - 12-66.94%, Al ₂ O ₃ -5-19.94%, Fe ₂ O ₃ -0.81-14.72 %	204 000 000
50	Kuarci	94-96.5 % SiO ₂ , Al ₂ O ₃ 1.78-3.17 %, Fe ₂ O ₃ 0.54-0.64 %, CaO+MgO 0.27-0.89 %, TiO ₂ 0.10-0.28 %	770 000 000
51	Kuarcite	SiO ₂ 90,32-99,51 %, Al ₂ O ₃ 0,086 %, Fe ₂ O ₃ 0.032 %, CaO 0.014-0,078 %, MgO 0,015 %.	9 600 000
52	Rera kuarcore	SiO ₂ 83-88 %, Al ₂ O ₃ 5-8 %, Fe ₂ O ₃ 0.2-3.0 %, Na ₂ O 1.4-1.75 %, CaO 0.9-1.8 %, MgO 0.6-2.2 %,TiO ₂ 0.1-0.12 %.	1 560 000 000
53	Kripa e gurit	NaCl - 81.95-82 %, CaSO ₄ 4.8-4.9%	218 400 000
54	Fosforitet	P ₂ O ₅ 4-12%, CaO 48-50%, SiO ₂ 5-8.5%, U ₃ O ₈ > 0.005	182 720 000
55	Squfuri	S - 2-51%	4 480 000
56	Inertet lumore	Rere 20-65.9%, zaje 16-83.2%, pluhur 1-3% (CaO 44.6-55.9%, MgO 0.25-1.55%, SiO ₂ 0.33-11.57%, Fe ₂ O ₃ 0.04-1.93%)	300 000 000
57	Bariti	BaO 65.7 %, SO ₃ 34.3 %.	6 231 107
58	Feldshpate, albitofire	Al ₂ O ₃ - 17.74%, SiO ₂ - 71.2%, Na ₂ O -3.47%, K ₂ O - 4.42%	204 161 540
59	Talku	CaO 0.37-, MgO 1.09%, SiO ₂ 68.4%, Al ₂ O ₃ - 18.58%	254 219 112
60	Fluoriti	CaF ₂ =39.82% dhe SiO ₂ =39.43%.	7 504 200
61	Shkrifërimet	kuarci, zirconi, ilmeniti, rutili, sfeni, leukokseni, monaciti, titanomagnetiti, mikat, piriti e pak kromit. Të vleresuara me 0.3 % ZrO ₂ , e deri 3 % TiO ₂ .	67 500 000
62	Pirofiliti	SiO ₂ 64-75 %, MgO 0.46-1.7 %, Al ₂ O ₃ 13-18 %, Fe ₂ O ₃ 1.1-4.6 %, CaO 0.2-0.5 %.	24 000 000
Totali I vleres se mineraleve të vleresuara nga ana sasiore dhe cilesore			127 909 469 003
63	Minerale të pavleresuara ne menyre sasiore	Analizat cilesore jane të cunguara ndaj vlere totale e tyre eshtë e perafruar	30 000 000 000
Totali i vleres se mineraleve të pranuarra prezente ne Shqiperi deri sot ne konceptin e vleresimit të tyre nga ana cilesore dhe sasiore.			157 909 469 003

Shenim: Per mineralet ndertimore eshtë bere nje peraftrim me prodhimin vjetor mesatar per nje periudhe 50 vjeçare







Grafiku i Vleres ne USD te rezerves minerale të vleresuar ne produkt të shitshem me cmimet ne tregun global per vitin 2025 sipas llojit te mineralit

Pavaresisht faktit qe sektori minerar nuk është me sektor prioritar ai mund të jetë nje promotor i rendesishem i zhvillimit ekonomik, sidomos per ekonomitë e zonave rurale.

Aktualisht akoma ne po prodhojme ne pjesen dermuese minerale të paperpunuara. Perpunohe ne sasi të vogel ne produkte të ndermjetme minerare. Me këtë forme zhvillimi jo vetëm qe humbasim financiarisht, por nuk jemi konkruues ne tregun european dhe per me teper atë global. Produktet finale minerare kane mundesi me të madhe të jene produkte konkruuese ne tregun european dhe global. Ato sherbejne per te shtuar vleren e prones publike (të

ardhurat nga renta dhe taksat e tjera per pasuritë minerare), vendet e punes, rritur produktet ne eksport me vlere jo me sasi, hapur rrugen per investime të industrive pasuese qe lidhen me atë minerare.

Prodhimi minerar ka patur luhatjet e tij të varuara kryesisht nga tregu global sidomos kur flasim per mineralet metalike gjithsesi mund të themi se industria minerare po zhvillohet në përputhje me kërkesat e ekonomisë së tregut, ka aplikuar një strukturë të ndryshme nga ajo tradicionalja, duke ruajtur thelbin e saj. Industria minerare ka humbur potencialin e saj ne kuader të ekonomise ne tëresi, kontributi i saj ne PBB ka rene me here krahasuar me atë të para viteve 1990, por ruan akoma pjesen dermuese te eksporteve.



Aktualisht në industrinë minerare janë aktive 552 leje minerare (raporti i fundit i AKBN 2023) dhe 2784 punonjes (raporti i fundit i Albeiti 2022), Pergjatë ketyre viteve është rritur prodhimi i mineraleve jo metalore, kryesisht për prodhimin e materialeve të ndërtimit të gelqeroreve, çimentos, gurët dekorative, etj, duke rritur gjithashtu gamen e mineraleve të shfrytëzueshme ne 44 lloje mineralesh ndertimore qe zene rreth 65-75% të prodhimit të pergjithshem

minerar. Aktualisht është imperative aplikimi rigoroz i bazes legale të miratuar dhe rishikimi i saj ne drejtim të permiresimit dhe perafimit me legjislacionin e BE. Kjo per gjithë pjeset e ekulibrit dinamik të veprimtarive minerare atij të *zhvillimit racional dhe miqesor me mjedisin*.

Ne kuader të organizmit ligjor dhe institucional të sektorit, adaptimi i legjislacionit europian dhe zhvillimi i kapaciteteve njerezore duhet të mbeshtët në tre elementë:


- ✓ *Legjislacion i mirepërcaktuar*; me permiresim dhe pershtatje legjislacioni që të përfshijë e udhëheqë dinamikën e zhvillimit të ekonomisë minerare, të jetë koherent në njohjen e situatës dhe zhvillimit prespektiv në aktivitetin minerar, t'i paraprije proceseve evropiano-integruese me nje perafim me të mire të ligjit minerar me kerkesat e kohes se sotme europiane. (*Lehtësimi i procedurave burokratike; Ofrimi i lehtësive dhe i masave nxitëse për zhvillimin e biznesit privat në aktivitetin minerar; Shmangien e dublimeve dhe mbivendosjen e kompetencave të organeve menaxhuese; Përsosja e vazhdueshme e legjislacionit dhe e normave në fuqi për t'ju pergjigjur dhe harmonizuar kërkesat e biznesit dhe adaptuar direktivat europiane*);
- ✓ *Institucione eficente*; nepermjet ndërtimit të strukturave të afta të menaxhojnë aktivitetin minerar dhe të zbatojnë me perpikmëri kërkesat e ligjeve në fuqi. Persosja institucionale, ridimesionimi i sistemit të administratës minerare ne qendrore dhe periferike (*reduktime ne numur, dhe vendosje të meritoktracise*), me qëllim që t'u përgjigjet nevojave të shtruara nga industria e ristrukturuar minerare dhe gjithashtu të kontribojë në një zhvillim të qëndrueshëm. Parimet kryesore mbi të cilin duhet të ndërtohen strukturat minerare dhe të përcaktohen funksionet e organeve menaxhuese të industrisë minerare duhet të jenë: Parimi RESPEKTIM I LIGJIT nga të dy palët. Organet menaxhuese të industrisë minerare duhet t'i kushtojnë një rëndësi të vëçantë atyre masave, që në përputhje me ligjin dhe pa e shkelur asnjëherë atë, të sigurojnë HARMONIZIMIN e interesave të shtetit me ato të privatit, pasi Shteti, si përfaqësues dhe mbrojtës i interesave të të gjithë shoqërisë, duhet të jetë njëkohësisht arbiter i paanshëm dhe të respektojë të drejtat e biznesit privat, dhe për këtë arsye duhet t'i kryejë funksionet e tij në PARTNERITET me këtë të fundit.
- ✓ *Administratë profesionale dhe me integritet*; per përsosjen e metodave të menaxhimit racional dhe me efektivitet të burimeve minerare nepermjet rritjes se nivelit profesional të strukturave administrative nepermjet trainimit profesional; rritja e bazes infrastrukurore të veprimtarise se tyre; bashkepunim mes institucioneve administrative minerare e mjedisore; aktivizim e perfshirje të aftësive shkencore, teknike, mësimore dhe kërkimore-shkencore në fushën e mineraleve, metaleve dhe energjisë dhe bashkepunim real mes institucioneve gjeologjike minerare dhe universiteteve.

Prodhimi i mineraleve metalike, të ardhurat dhe kontributi i industrise minerare ne tëresi karshi PBB dhe eksporte ne vitet 1989-2024

Vitet	1989	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
PPB (ne USD)	2 253 090 000	2 028 553 750	1 099 559 028	652 174 991	1 185 315 468	1 880 950 864	2 392 764 853	3 199 640 815	2 258 513 974	2 545 964 541	3 212 121 651	3 480 355 258
PPB (ne milion USD)	2 253	2 029	1 100	652	1 185	1 881	2 393	3 200	2 259	2 546	3 212	3 480
Te ardhurat nga industria minerare (ne USD)	1 289 064 776	673 743 059	303 078 522	47 716 555	28 005 462	16 765 452	17 531 042	26 919 337	36 146 660	41 749 044	48 621 197	57 537 823
Te ardhurat nga industria minerare (ne milion USD)	1 289	674	303	48	28	17	18	27	36	42	49	58
Kontributi ne perqindje I Industrise minerare karshi PPB (ne %)	57,21%	33,21%	27,56%	7,32%	2,36%	0,89%	0,73%	0,84%	1,60%	1,64%	1,51%	1,65%
Te ardhurat nga te gjithë eksportet (ne USD)	3 281 536 568	2 976 225 549	2 124 000 423	1 950 267 917	2 142 975 597	1 894 770 489	205 308 234	150 024 090	112 473 513	119 063 713	95 577 976	93 519 610
Te ardhurat nga eksportet minerare (ne USD)	1 945 372 090	673 743 059	303 078 522	47 716 555	28 005 462	16 765 452	17 531 042	26 919 337	36 146 660	41 749 044	48 621 197	57 537 823
Perqindja ne eksporte e produkteve minerare (ne %)	59,28%	22,64%	14,27%	2,45%	1,31%	0,88%	8,54%	17,94%	32,14%	35,06%	50,87%	61,52%
Prodhimi I mineralit te kromit (ne ton)	1 101 260	909 710	586 760	322 310	291 130	222 880	236 360	236 360	157 200	150 290	79 450	82 796
Prodhimi I mineralit te bakrit (ne ton)	1 135 659	930 768	561 389	240 000	240 000	178 000	187 765	187 765	24 895	53 477	34 348	0
Prodhimi I mineralit te hekur nikelit (ne ton)	1 179 345	930 893	970 000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali I mineraleve metalike	3 416 264	2 771 371	2 118 149	562 310	531 130	400 880	424 125	424 125	182 095	203 767	113 798	82 796
Vitet	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
PPB (ne USD)	3 922 100 794	4 348 068 242	5 611 496 257	7 184 685 782	8 052 077 248	8 896 075 005	10 677 324 853	12 881 352 894	12 044 205 550	11 926 926 616	12 890 760 315	12 319 834 195
PPB (ne milion USD)	3 922	4 348	5 611	7 185	8 052	8 896	10 677	12 881	12 044	11 927	12 891	12 320
Te ardhurat nga industria minerare (ne USD)	68 219 773	78 752 729	85 484 326	93 063 202	146 187 688	165 334 752	197 873 158	239 191 997	185 036 539	141 985 069	166 854 790	190 210 156
Te ardhurat nga industria minerare (ne milion USD)	68	79	85	93	146	165	198	239	185	142	167	190
Kontributi ne perqindje I Industrise minerare karshi PPB (ne %)	1,74%	1,81%	1,52%	1,30%	1,82%	1,86%	1,85%	1,86%	1,54%	1,19%	1,29%	1,54%
Te ardhurat nga te gjithë eksportet (ne USD)	108 725 263	109 487 086	117 776 852	132 084 836	150 248 457	158 602 248	189 318 251	269 649 219	167 903 526	131 269 215	157 228 552	182 750 934
Te ardhurat nga eksportet minerare (ne USD)	68 219 773	78 752 729	85 484 326	93 063 202	102 331 382	115 734 326	138 511 211	167 434 398	129 525 577	99 389 549	116 798 353	133 147 109
Perqindja ne eksporte e produkteve minerare (ne %)	62,75%	71,93%	72,58%	70,46%	68,11%	72,97%	73,16%	62,09%	77,14%	75,71%	74,29%	72,86%
Prodhimi I mineralit te kromit (ne ton)	74 060	83 173	152 742	144 809	162 772	58 333	187 498	230 000	370 239	322 597	349 873	360 349
Prodhimi I mineralit te bakrit (ne ton)	0	0	2 000	27 523	68 312	0	98 000	105 000	114 336	139 926	305 284	479 720
Prodhimi I mineralit te hekur nikelit (ne ton)	0	0	33 375	0	0	78 000	369 559	353 320	68 840	269 300	363 723	75 017
Totali I mineraleve metalike	74 060	83 173	188 117	172 332	231 084	136 333	655 057	688 320	553 415	731 823	1 018 880	915 086
Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
PPB (ne USD)	12 776 224 497	13 228 147 516	11 386 853 113	11 861 199 831	13 019 726 212	15 379 509 892	15 585 105 131	15 241 458 745	18 032 010 564	19 017 242 586	23 547 179 830	24 000 000 000
PPB (ne milion USD)	12 776	13 228	11 387	11 861	13 020	15 380	15 585	15 241	18 032	19 017	23 547	24 000
Te ardhurat nga industria minerare (ne USD)	294 650 821	328 335 634	236 253 541	191 181 861	152 909 344	228 571 429	616 450 185	490 922 958	548 059 615	681 392 591	558 741 924	439 105 634
Te ardhurat nga industria minerare (ne milion USD)	295	328	236	191	153	229	616	491	548	681	559	439
Kontributi ne perqindje I Industrise minerare karshi PPB (ne %)	2,31%	2,48%	2,07%	1,61%	1,17%	1,49%	3,96%	3,22%	3,04%	3,58%	2,37%	1,83%
Te ardhurat nga te gjithë eksportet (ne USD)	244 710 004	277 387 001	203 095 149	166 333 651	138 751 072	301 252 237	271 818 347	338 537 094	576 139 586	772 303 458	446 950 628	357 821 490
Te ardhurat nga eksportet minerare (ne USD)	206 255 575	229 834 944	165 377 479	133 827 303	107 036 541	220 123 176	201 334 578	234 386 445	405 643 558	488 053 918	312 790 484	223 176 578
Perqindja ne eksporte e produkteve minerare (ne %)	84,29%	82,86%	81,43%	80,46%	77,14%	73,07%	74,07%	69,24%	70,41%	63,19%	69,98%	62,37%
Prodhimi I mineralit te kromit (ne ton)	521 080	683 874	646 639	726 671	808 016	1 156 444	1 014 448	626 627	650 200	932 686	920 770	680 000
Prodhimi I mineralit te bakrit (ne ton)	507 105	259 137	140 386	0	0	236 459	394 530	333 715	618 518	641 245	460 628	423 000
Prodhimi I mineralit te hekur nikelit (ne ton)	215 086	493 867	742 180	439 082	548 762	385 710	325 243	432 673	427 650	174 918	63 131	24 000
Totali I mineraleve metalike	1 243 271	1 436 878	1 529 205	1 165 753	1 356 768	1 778 613	1 734 221	1 393 015	1 696 368	1 748 849	1 444 529	1 127 000

Burimi i informacionit: Raprte te BB, MIE, AKBN, SHGJSH, ALBEITI, INSTAT (Shenim: Te dhenat ne disa raporte kane mosperputhje me njeri tjetrin sidomos raportet e keytre 10 viteve te fundit te publikuara nga institucionet minerare dhe INSTAT qe kane diferenca deri ne 10%.) Vitit 2024 sipas te dhenave paraprake

PRODHIMI I MINERALEVE METALIKE NE VITE (MINERALE KROMI, BAKRI DHE HEKUR NIKELI NE TON)



Prodhimi i mineraleve metalike ne vite (1938-2024)

